



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0412

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AGS Corporation SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” me numër të prokurimit 206-23-11488-1-1-1, me 19/08/2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa për LOT 3 dhe LOT 7 e OE AGS Corporation SH.P.K. me nr. 2024/0412, e datës 10/05/2024, kurse vendimi i AK MINISTRIA E SHËNDETËSISË lidhur me aktivitetin e prokurimit Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-së” me numër të prokurimit 206-23-11488-1-1-1, mbetet në fuqi.

2. Konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP, konfiskohen mjetet e depozituara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 24.10.2023, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-se” për LOT 3 dhe Lot 7 me nr. të prokurimit: "206-23-11488-1-1-1". Ndërsa me datën 03.04.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku është rekomanduar për kontratë OE “Uni Care SH.P.K.”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës Lot 3= 150,000.00 €, Lot 7= 120,000.00 €.

Me 05.04.2024, "Ags Corporation Sh.P.K."ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 29.04.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10.05.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "AGS Corporation Sh.P.K." me nr. 412/2024 për lidhur me aktivitetin "Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njesite organizative te QKUK-se"" për LOT 3 dhe Lot 7 me nr. të prokurimit: "206-23-11488-1-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Ags Corporation Sh.P.K."janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): "Në nenin 3.1 të FDT-së është kërkuar si më poshtë: Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit (FTD). Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar këtë deklaratë, prandaj është i papërgjegjshëm, sepse kjo kërkesë është decisive dhe kërkesë e kualifikueshmërisë."

Pretendimi i dytë (II) : "Seksioni II. Fleta e të e Dhënave të Tenderit (FTD).Krijimi i dokumenteve të 21.3 Tenderuesi duhet të dorëzoj me tenderin e tij listën e pjesëve rezervë të furnizimeve të përshkruar me specifikimet teknike, Aneksi 1. e Tenderit - Furnizim- Procedurë e Hapur. Numri i Prokurimit: 206-23-11488-1-1-1; Titulli Ri-tender "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative te QKUK-së" përshtatshme të mallrave dhe shërbime të njëanshme OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar listën e Pjesëve Rezerve te përshkruar me specifikime teknike, ANEKS 1 -prandaj ky OE është i papërgjegjshëm, sepse kjo kërkesë është decisive dhe kërkesë e kualifikueshmërisë."

Pretendimi i tretë (III) : "Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme LOT 3 - Mandatory or equivalent Technical specifications Ultraze (me sonde gjinekologjike 3D,4D) sond konvekse abdominale 3.5 Mhz dhe sonde vaginale me mundësi së vendosjes se guide për aspirim të oociteve si dhe softwer për aspirimi të oociteve – LOT 3. 1.ULTRAZE (me sonde gjinekologjike 3D,4D) sond konvekse abdominale 3.5 Nfliz dhe sonde vaginale me mundësi së vendosjes se guide për aspirim të oociteve si dhe softver për aspirim të oociteve Copë 2 GUEDE për ultrazë për sond vaginale për aspirim të oociteve Q 6 cope).Ne dokumentet e OE të rekomanduar për kontrate - ne katalog MUNGON E markuar GUIDA PER ASPIRIM TE OOCITEVE , edhe pse ka qenë kërkesë e detyrueshme, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet, e jo të favorizohet dhe rekomandohet për kontratë."

Pretendimi i katërt (IV) : “Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme Additional accessories as well: a). Printer colour ink jet (1 copë) and b) . BW printer (1 copë) include paper for printers 30pcs for each printer, and 60pcs of ultrasound gel approxiinatly 200ml për 1psc c). UPS- (2 copë) with autonomv 30 min. Ne dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë-NUK ESHTE OFRUAR FARE AKSESORI UPS (I nevojshëm për autonomi te pajisjes dhe aksesoreve), e detyrueshme sipas ANEKS 1 - prandaj ky OE është i papërgjegjshëm.”

Pretendimi i parë (I) për LOT 7: “Seksioni II. Fleta e të Dhënave të tenderit (FTD).Krijimi i dokumenteve të përshtatshme të mallrave dhe shërbime të ngjashme. 21.3 Tenderuesi duhet të dorëzoj me tenderin e tij listën e pjesëve rezervë të furnizimeve të përshkruar me specifikonte teknike, Aneksi 1.Ne dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë-Mungon Lista e Pjesëve Rezerve te përshkruara me specifikime teknike, edhe pse ka qenë kërkesë obligative, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca e jo të rekomandohet për kontratë. Në këtë rast kemi favorizim të hapur të këtij operatori ekonomik, me rastin e rekomandimit për kontratë për lot 3 dhe Lot 7. Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.29.04.2024, ku në këtë vendim nuk është dhënë asnjë arsye konkrete apo dëshmi konkrete për të arsyetuar njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe për të kundërshtuar pretendimet tona ankimore. Në lidhje me ofertën tonë dhe arsyen e eliminimit, përsëri AK-së vetëm ka përshkruar disa specifikimet teknike në mënyrë të përgjithësuar duke insistuar se nuk i kemi plotësuar. Se përgjigja është joprofesionale, madje qesharake kuptohet kur në këtë vendim thuhet se në ofertën e juaj nuk i keni plotësuar një numër shumë të madh të spccifikimeve teknike. Po ashtu jo profesionalizmi dhe njëanshmëria e AK-së, në raport me dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë dhe nga ne, vërehet kur ka konstatuar se pajisja e OE rekomanduar për kontratë nëse krahasohet me pajisjen tonë, është më e kompletuar dhe më kualitative, sipas profesionistëve-bioinxhinierëve dhe mjekëve të gjinekologjisë. Fillimisht sqarojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve bëhet në raport me kërkesat e dosjes së tenderit e jo në raport me kompanitë ofertuese. Neni 40.6 i RRPP Nr. 001/2022 e përcakton qartë: 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Pra, nga kjo dispozitë kuptohet qartë se tenderi dhe dëshmitë se a është i përgjegjshëm apo jo një OE, krahasohen me kriteret e përzgjedhjes, specifikimet teknike të kërkuara dhe nga aspekti administrativ, e jo duke krahasuar ofertat e ofertuesve në tender. Fjala më e kompletuar dhe më kualitative, tregon subjektivizëm në vlerësim dhe në përgjigjen e dhënë. Autoriteti kontraktues duhet të bëjë vlerësimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë dhe të ofertës tonë, e të secilit ofertues në raport me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me specifikat teknike të detyrueshme, sepse ky është obligim ligjor e nuk mund të bëhen vlerësime sipas dëshirës së tyre se cila pajisje është më kualitative dhe më e kompletuar. Neni 25 i RRPP Nr.01/2022 përcakton qartë: 25.5 Kriteret e përzgjedhjes: a.në asnjë mënyrë nuk mund të përdorën si kriteret të dhënies së kontratës b. nuk mund të kenë peshë të caktuara; c. ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon. Pra kriteret e përzgjedhjes janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon, e kjo do të thotë se kërkesat ose plotësohen ose nuk plotësohen, prandaj autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim edhe me këtë dispozitë të legjislacionit sekondar ku ka bërë vlerësimin e ofertave dhe kur ka dhënë këtë përgjigje. Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim, është munduar të zhvendos vëmendjen tek profesionistët, mirëpo ne ju sqarojmë se profesionistët e fushave përkatëse mund të japin mendime se cila pajisje është më e mirë, por në procedurat e tenderimit ekzistojnë kërkesa në dosje të tenderit të cilat duhet të

përmbushen që të konsiderohet një ofertë e përgjegjshme, e nuk mund të bëhen vlerësime mbi bazën e mendimeve qoftë edhe profesionale për pajisje të caktuara. Dihet që edhe specifikimet teknike përgatiten nga njësitë kërkuese, e që do të thotë përgatiten nga profesionistë të fushave përkatëse, prandaj nuk mund të anashkalohen as kërkesat e as specifikimet teknike të detyrueshme në këtë tender. Në fund të vendimit, AK-së e ka cekur se profesionistët kanë rekomanduar që ndaj OE të rekomanduar për kontratë të kërkohet konfirmimi rreth aksesorëve të kërkuar, e të cilët do të jenë pjesë e kontratës dhe obligative për furnizim. Ky rekomandim, tregon qartë se edhe vetë autoriteti kontraktues e ka pranuar se OE i rekomanduar për kontratë për Lot 3 dhe 7 është i papërgjegjshëm për shkak se nuk ka ofruar listën me pjesë rezervë, mirëpo AK-së përsëri është munduar të mbështetet në rekomandimet e ekspertëve. Edhe në këtë rast ekspertët nuk mund ti dinë procedurat e prokurimit dhe dispozitat që ndalojnë të kërkohen sqarime për të gjitha dokumentet. Po ashtu dokumentet ekzistenca e të cilave nuk mund të vërtetohet në mënyrë objektive se ka ekzistuar para datës së ofertimit nuk mund të pranohen dhe kjo parashihet në nenin 72.3 të LPP-së. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezultojnë se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues, sepse nuk janë trajtuar të gjithë operatorët ekonomik njëjtë por është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Gjithashtu paragrafi 6 i kësaj dispozite, pika (vi) shkruan qartë citojmë “që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”. Ndërsa në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë për Lot 3 dhe 7 është i përgjegjshëm dhe oferta e tij nuk përputhet me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “AGS Corporation Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 7, 10, 28, 59, 60, 62 të LPP-së. Duke pasur parasysh të gjitha arsyet faktike dhe ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr: Vendim Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “AGS Corporation Sh.P.K” për Lot 3 dhe 7 Anulohet, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në Rivlerësim për Lot 3 dhe 7 dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: “Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim e datës 05.04.2024, duke marrë parasysh se bazuar në nenin 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) pajisja e ofertës së rekomanduar nëse krahasohet me pajisjen e juaj, është me e kompletuar dhe me kualitative, sipas profesionisteve - bioingjiniereve dhe mjekeve të gjinekologjisë. Në ofertën e juaj ju nuk i keni plotësuar një numër shume të madhe të specifikave teknike, të cilat janë të cekura si arsye të eliminimit të ofertës tuaj, përmes B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 03.04.2024. Mungojnë specifikat teknike të Detyrueshme në katalogun e ofertuar, specifikat të cilat janë të bashkangjitura në kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimet e juaja ankimore janë shqyrtuar edhe nga profesionist shtese nga SHSKUK dhe te cilët e kane konfirmuar qëndrojnë arsyet e eliminimit te ofertës AGS Corporation SH.P.K. qe janë dhënë ne B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar te datës 03.04.2024. Njëkohësisht profesionistet kane rekomanduar qe ndaj OE te rekomanduar te kërkohet konfirmimi rreth aksesoreve te kërkuar e te cilët do te jene pjese e kontratës dhe obligative për furnizim. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14/05/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues ndërsa ekspertin teknik me date 14/05/2024 për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 412/2024, ndërsa me datë 31/05/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik me nr. 2024/412 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues për LOT 3 dhe LOT 7 të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK Nuk Pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa OE ka deklaruar se Pajtohet me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se duhet mbajtur seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtraset e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin. Andaj, kjo senacë është mbajtur me dt. 19.07.2024, ku morën pjesë të gjitha palët në procedurë, përfshirë përfaqësuesin e AK, përfaqësuesin e OE dhe eksperti shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtraset dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “AGS Corporation Sh.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/412 kanë vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Ekspertja shqyrtuese, meqenëse nuk posedon profesionin adekuat për shqyrtimin e këtij pretendimi, atëherë ka kërkuar që të angazhohet një ekspert teknik i fushës. Tutje, Ekspertja teknike lidhur me pretendimin e parë të OE ankues sqaron se, fillimisht AK nuk ka specifikuar se cilat specifikacione nuk i plotësojnë pajisjet me te cilat ka ofertuar OE ankues (Eliminuar) por i ka dërguar te gjitha specifikacionet si te paplotësuar. Duke marrur parasysh kërkesën e DT e konsideroj se OE ankues i plotëson kriteret konform nenit 59.4 te LPP-së, për faktin se AK në aknes 1 ka kërkuar, specifika LOT 3 - Mandatory or equivalent Technical specifications. Po ashtu, OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret baze siç janë : Nuk ka dorëzuar deklaratën për specifikacione teknike për mallrat e ofruar. Nuk ka dorëzuar listën e pjeseve rezerve te pershkuara me specifikacione teknik. Mungon e markuar ne katalog Guida për ultraze per sonde vaginale per aspirim te oociteve. Ekspertja shqyrtuese lidhur me

pretendimin e OE ankues kundër OE të rekomanduarit sqaron se, sa i përket kërkesës së AK-së në FDT pika 3.1, OE i rekomanduar në ofertë nuk posedon deklaratën e specifikuar, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.”

Konstatimi i dytë (II) : “ Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues kundër OE të rekomanduarit sqaron se, sa i përket kërkesës së AK-së në FDT pika 21.3, në ofertë OE i rekomanduar nuk ka të bashkangjitur listën e pajisjeve rezervë të furnizimeve të përshkruara me specifikimet teknike, Aneksin 1, sipas kërkesës në FDT 21.3. Andaj si e tillë pretendimi OE ankues gjendet i bazuar.”

Konstatimi i tretë (III) : “Ekspertja shqyrtuese, meqenëse nuk posedon profesionin adekuat për shqyrtimin e këtij pretendimi, atëherë ka kërkuar që të angazhohet një ekspert teknik i fushës. Tutje, Ekspertja teknike lidhur me pretendimin e tretë të OE ankues sqaron se, në katalogun e ofruar nga OE i rekomanduar, mungon e markuar ne katalog Guida për ultraze për sonde vaginale për aspirim te oociteve, kurse AK në DT ka kërkuar: Kërkesa 2. Operatori ekonomik te prezantoj katalogun (broshurën) e pajisjeve te ofruara dhe te nënvizohen ne mënyrë te qarte produktet dhe specifikat teknike te ofruara. Nëse ofrohet broshura, duhet te specifikohet linku i web faqes. Deshmia 2. Katalogu (broshura) e pajisjeve te ofruara me selektim te qarte te produkteve dhe specifikave teknike te ofruara Andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.”

Konstatimi i katërt (IV) : “Ekspertja shqyrtuese, meqenëse nuk posedon profesionin adekuat për shqyrtimin e këtij pretendimi, atëherë ka kërkuar që të angazhohet një ekspert teknik i fushës. Tutje, Ekspertja teknike lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues sqaron se, po ashtu, ne ofertën e OE te rekomanduar nuk gjendet UPS e cila është më se e nevojshme për sigurinë e dhe autonominë e pajisjeve dhe aksesoreve. Përderisa, kur ofertuesit kanë kërkuar sqarime nga AK rreth specifikimeve teknike lidhur për UPS, se nëse mund ta ofrojnë edhe me autonomi 10 min, përgjigja e AK-së ishte kjo: c) JO, UPS duhet të ofrohet me autonomi 30 min. Do të thotë se AK as UPS me autonomi 10 min , nuk ka lejuar që të ofrohen, ndërsa në rastin konkret OE i rekomanduar nuk posedon fare UPS në ofertën e tij. Pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.”

Konstatimi i parë (I) për LOT 7 : “Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues kundër OE të rekomanduarit sqaron se, sa i përket kërkesës së AK-së në FDT pika 21.3. në ofertën e OE të rekomanduar nuk gjendet lista e pajisjeve rezervë. Andaj si e tillë pretendimi OE ankues gjendet i bazuar.”

Përfundimi i konstatimeve te eksperteve : “Ekspertja teknik dhe shqyrtuese konsiderojnë se AK nuk ka vlerësuar ofertat konform LPP-së, bazuar në letrën standarde për tenderuesit e eliminuar, AK nuk ka specifikuar se cilat specifika nuk i plotëson OE ankues, përderisa në katalogun e ofruar OE ankues posedon edhe specifika ekuivalente konform Aneks 1 në DT, po ashtu sipas sqarimeve më lartë lidhur me pretendimet ankimore të ngritura kundër OE të rekomanduar, të cilat gjenden të bazuar, andaj si e tillë rekomandohet AK që lëndët LOT 3 dhe LOT 7 ti kthej në rivlerësim, duke vlerësuar ofertat konform LPP-së, rregullores për prokurim publik nr.001/2022, Udhëzuesit për prokurim publik nr.001/2023.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për

Njësitë organizative të QKUK-se” për LOT 3 dhe Lot 7 me nr. të prokurimit: “206-23-11488-1-1”. Paneli shqyrtues erdhi në këtë konstatim pas shumë kërkesave dhe vlerësimeve të bëra lidhur me këtë lëndë dhe kundërshtimit të fuqishëm të bërë nga ana e AK. Fillimisht Paneli Shqyrtues konsideroi se për vendimarrje meritore duhet të mbahet seancë dëgjimore ma palë, pasi që raporti fillestar i dt. 31.05.2024 i ekspertëve shqyrtues dhe teknik nuk përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore, këtë paneli shqyrtues e konstatoi edhe në senacën e mbajtur me çrast eksperti teknik nuk ka nxjerrë asnjë konstatim konkret, nuk ka komunikuar me asnjërin palë ashtu siç kërkohet me nenin 113 dhe 114 dhe pasi që deklaroi edhe vetë eksperti teknik se nuk ka pasur njohuri se për cilat specifika është eliminuar ankuesi, po ashtu, edhe ekspertja profesionale i ka nxjerru disa konstatime të cilat nuk janë pjesë e kërkesave të DT dhe nuk janë as në konsistencë edhe me vendimet tjera të OSHP.

Si rrjedhojë, PSH, kërkoi nga ekspertja teknike që ta plotësojë ekspertizën e saj dhe të mbledhë të gjitha informacionet e mundshme dhe të vijë deri tek një konstatim profesional i sa rreth ofertës së OE ankues. Me çrast ekspertja teknike e ofron plotësimin e ekspertizës më dt. 24.07.2024 duke rekomanduar që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar për LOT 3 dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për këtë LOT. Ky plotësim ju është dërguar të gjitha palëve dhe OE ankues e kundërshton këtë plotësim me arsyetim se ky ndryshim i rekomandimit nga ana e ekspertës teknike është i nxitur nga ana e Panelit Shqyrtues. Kështu që, Paneli Shqyrtues duke u përballur me dy rekomandime të ndryshme vendosi që më e arsyeshme dhe transparente është kërkesa për të bërë një superekspertizë dhe të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore.

Eksperti shqyrtues me dt. 13.08.2024 dorëzoi superekspertizën e tij me rekomandimin si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i AK për LOT 3 dhe LOT 7." Duke u përgjigjur në të gjitha pretendimet ankimore dhe ndaj OE të rekomanduar për kontratë por edhe në pretendimet ndaj eliminimit të OE ankues. Ky raport i superekspertizës ju është dërguar të gjitha palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues në superekspertizën e tij të dt. 13.08.2024, i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AGS Corporation Sh.P.K.” dhe se, argumentimi në raportin e eksperteve është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të superekspertizës dhe në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues për LOT 3 dhe LOT 7 “AGS Corporation Sh.P.K.” janë të pa bazuara.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ri-tender “Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për Njësitë organizative të QKUK-se” për LOT 3 dhe LOT 7 me nr. të prokurimit: “206-23-11488-1-1-1” , që vendimi i AK të mbetet në fuqi.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit mos të kthehet në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - AGS Corporation SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: